



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale  
Mbledhja nr. 29  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 302  
Prishtinë, më 21 nëntor 2018, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Besa Baftiu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Enver Hoti, Flora Brovina, Bekim Haxhiu, Miljana Nikoliq dhe Fikrim Damka.

**Munguan:** Drita Millaku, Haxhi Avdyli, Time Kadrijaj dhe Naser Rugova.

**I ftuar:** Skender Reçica, ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

**Pjesëmarrës tjerë:** Brikenë Hoxha – IKS, Donat Dedi, IKS dhe mediat.

**Mbledhjen e kryesoi,** Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

**RENDI I DITËS:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 24.9.2018 dhe 10.10.2018;
3. Takim me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Skender Reçica
  - Vonesat në përmbushjen e agjendës legjislative;
  - Projeksionet buxhetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2019;
  - Zbatimi i Ligjit për personat e dhunuar gjatë luftës;
  - Reforma e sistemit pensional në Kosovë;
4. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 24.9.2018 dhe 10.10.2018;

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 24.9.2018 dhe 10.10.2018, u miratuan pa

vërejtje.

### **3. Takim me ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale z. Skender Recica**

- **Vonesat në përmbushjen e agjendës legjislative;**
- **Projeksionet buxhetore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2019;**
- **Zbatimi i Ligjit për personat e dhunuar gjatë luftës;**
- **Reforma e sistemit pensional në Kosovë.**

**Besa Baftiu, kryetare,** tha se ne si Komision kemi bërë një plan të punës konform planit legjislativ që na vije nga Qeveria. Sipas këtij plani, Projektligjet që vijnë nga dikasteri juaj ka pasur mjaftë vonesa. Projektligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, wshtw dashur të vijë në Kuvend, në prill të këtij viti për plotësim dhe ndryshim, por ai nuk erdhi. Përse janë bërë këto vonesa?

Cilat kanë qenë kërkesat e juaja për Qeverinë, sa i përket projeksionit buxhetor për vitin 2019, dhe sa janë pranuar ato kërkesa nga Qeveria? Është bërë një analizë buxhetore për shqyrtimin e projekt buxhetit për vitin 2019 nga NDI-ja për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku shihet se 26 % e buxhetit shkon për Ministrinë tuaj. Gjithashtu, një shumë e madhe shkon edhe për skemat pensionale. Në këtë analizë shihet se ka rritje të numrit të punëtorëve të Inspektoratit të Punës, ka rritje gjithashtu prej 10 milionë euro për paraplegjikët dhe tetraplegjikët, gjithashtu ka rritje të stafit edhe në Ministrinë tuaj. Na tregoni pse është kjo rritje dhe pse nuk ka rritje të buxhetit edhe tek kategoritë e tjera?

Sa i përket Zbatimit i Ligjit për personat e dhunuar gjatë luftës, pse ka vonesa në shqyrtimin e aplikacioneve, ndërsa reforma e sistemit pensional, jemi skeptik se kur dhe si do të bëhet.

**Skender Recica, ministër,** tha se në agjendën legjislative të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, e cila është miratuar në fund të vitit 2017, ne si Ministri e kemi paraparë ti sjellim në Kuvend shtatë projektligje dhe një plotësim ndryshim, që ka të bëjë me Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Me marrjen e mandatit e kemi identifikuar që neni tetë, që ka të bëjë me pensionet e dyfishta, duhet të plotësohet dhe ndryshohet, pasi që është diskriminues, por ishin implikimet buxhetore të cilat e pamundësuan fillimin e plotësimit dhe ndryshimit të këtij Ligji.

Kërkesat që i kemi adresuar në Ministrinë e Financave për buxhetin e vitit 2019, në masë të madhe janë të akomoduar. Buxheti për vitin e ardhshëm do të jetë 465.809 milionë euro. Kemi paraparë rritje të stafit, konkretisht tek inspektorët për 15 pozita, për paga dhe mëditje, buxheti është 5.253 milion, për subvencione dhe transfere është 456 milionë euro, ku hynë skemat pensionale benifitet etj.

Për pensionet bazë, janë shtuar 20 milionë euro, pensioni për aftësi të kufizuar është zvogëluar për 2.7 milion euro për shkak se një pjesë kalon tek parapregjikët dhe tetraplegjikët, 10 milionë euro janë shtuar për pensionet kontributdhënës, pensioni familjar është shtuar për 3.3 milionë euro. Asistenca sociale është zvogëluar për 1,3 milionë euro, te pensionet e veteranëve është rritur buxheti për 1,8 milionë euro ndërsa te pensionet e invalidëve të punës, është shtuar buxheti prej 1.5 milion euro.

Ministria është duke e Zbatuar Ligjin për personat e dhunuar gjatë luftës dhe për tu zbatuar vendimet rreth këtij procesi, janë paraparë 1 milion euro për vitin 2018, ndërsa, nga 800 mijë euro për vitin 2019-2020. Sekretaria e komisionit i ka pranuar gjithsej 827 aplikacione, kurse 148 rasteve të shqyrtuara, u është njohur statusi i viktimës, me ç'rast shumica e këtyre personave edhe kanë filluar të marrin pensionet e tyre. Janë disa raste në rishqyrtim pas ankesave.

Në Kosovë nuk e kemi akoma një Sistem pensional çfarë duhet të jetë. Fatkeqësisht kemi skema të pensioneve të krijuara ad hock, ajo që është evidentuar është që Kosova nuk ka arritur të konsolidojë një skemë të sigurimeve sociale. Ka mungesë të një ligji bazik, ka mosharmonizim të skemave, ka pamjaftueshmëri financiare, ka një strukturë të vjetërsuar dhe kjo ka bërë që të vijmë deri tek reformimi i sistemit pensional.

**Fatmire Kollçaku**, tha se ndalja e ndihmave sociale për familjet, fëmijët e të cilëve kalojnë moshën pesëvjeçare është diskriminim për fëmijët. Gjithashtu edhe reformimi i sistemit pensional është shumë urgjent.

Duhet të rregullohet edhe çështja e kontratave të punës. Po e shohim sa vdekjet po ndodhin në vendet e punës, e të njëjtit nuk figurojnë askund. Punëdhënësit po fitojnë në kurriz të punëtorëve, përkushtimi më i madh i inspektorëve duhet të jetë që të shkojnë, jo kur ndodh rasti, por duke tentuar të parandalojnë atë. Ministria juaj duhet të ketë në fokus edhe personat që janë të sëmurë me sëmundje të rënda, që të gëzojnë pushim me pagesë gjatë marrjes së kimioterapisë.

**Flora Brovina**, theksoi se Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, vlerësoj si një ministri me shumë probleme. Secili ministër që ka ardhur në pushtet nuk e ka bërë atë që duhet. Sa i përket Sigurimeve Sociale, nga ne deputetet është kërkuar që 15 vite të ketë sigurime sociale, sepse këto sigurime sociale do ta rregullonin edhe pushimin e lehonisë. Nëse nuk është rregulluar me Ligjin që do të vijë, ne nuk e dimë se ku do të marrim të hollat për shtesat e fëmijëve. Reforma e sistemit pensional ka filluar mbrapsht. Në bazë të dokumenteve, kur jam përjashtuar në vitin 1990, unë kam pas 16 vite stazh pune, ndërsa pas luftës, stazh pune i kam 13 vite. Ku shkuan këto 16 vite të stazhit të punës?

Kam marrë pjesë në grumbullimin e të dhënave të grave të abuzuara seksualisht, që e quaj në krim kundër njerëzimit në nxjerrjen e këtij Ligji, pati shumë mangësi dhe komisioni e ka marrë përsipër që ta korrigjojë, ku kam qenë udhëheqëse e grupit dhe duke u nisur nga kjo unë nuk mendoj që është një Ligj i mirë, për të cilin kam shpresuar që do të jetë më funksional.

Numri i aplikacioneve nuk është i vogël, por rezultati nuk është i madh. Këta persona nuk ka pasur nevojë të marrin pensione, këta persona kanë kërkuar që të punojnë përmes ndërmarrjeve sociale përmes formave të tjera të punësimit formal, që t'ua ruajmë dinjitetin dhe të ndihen në mesin tonë të vlefshëm e jo çdo muaj të kujtojnë se përse i marrin këto para.

**Bekim Haxhiu**, tha se në Ministrinë tuaj shumë më shumë flitet për pensionet se sa për çështjen e punësimit. Jemi në fund të vitit dhe në agjendën legjislative kemi prit që të paktën koncepti dokumenti për Sistemin e ri Pensional, do të vijë në shqyrtim, por nuk erdhi.

Kemi pas disa vërejte kohëve të fundit prej ish- ushtarëve të TMK-së dhe nga familjet e dëshmorëve për shkak se iu është ndaluar një pension. Ligji për pensionimin për pjesëtarët e TMK-së është bërë vetëm për atë kategori dhe ata e gëzojnë pensionin edhe sipas Ligjit, dhe nenit 11, se edhe nëse janë në marrëdhënie të punës në sektorin publik apo privat, atëherë përse u është ndaluar pensioni?

Krejt në fund z. ministër besoj që jeni i informuar për rastin e Emine Biringjikut, punëtore e Ministrisë suaj, e cila me punën e saj në kuadër të Ministrisë shtetit ia kurseu 1 milion euro, në kohën kur familjarët e personave të vdekur, kanë marrë pensione. znj. Biringjiku tash ballafaqohet me gjykatën për një të drejtë të sajën që Ministria ia ka mohuar. Do të doja që ju personalisht të merreni me këtë sepse me këtë diskriminim që ju bëhet atyre që e kursejnë shtetin i demotivoni punëtorët e tjerë.

**Kryetarja**, tha se është e padrejtë që t'ju ndalet pensioni, sidomos familjarëve të dëshmoreve, është dashur të bëhet një zgjidhje urgjente.

Kur thatë që projeksionet buxhetore për vitin 2019, në masë të madhe janë marrë parasysh më intereson të dijë se këto dy projektligje që do të dalin nga koncepti dokumenti, që thatë pensioni bazë për Sistemin Pensional dhe Projektligji për Sigurime Sociale, a janë paraparë në buxhetin e vitit të ardhshëm dhe kur e parashiheni që këto projektligje të kalojnë në Qeveri?

Ligji për personat e dhunuar gjatë luftës e dimë që është një komision i përbërë nga 9 anëtarë, e dimë që një person është nga Instituti për Krime të Luftës. Me sa e dimë ky institut është mbyllur, a është zëvendësuar ky person apo vazhdon të jetë po i njëjti? Sa i përket buxhetit, një shumë e vogël shkon për punësim. E di që në planin e juaj qeverisës ka qenë që në çdo familje që nuk ka të punësuar të paktën të punësohet nga një anëtarë, sa e keni arritur këtë dhe sa është numri i këtyre familjeve që e kanë të punësuar një anëtarë?

**Skender Recica, ministër,** tha se natyrisht që jemi duke punuar në asistencën sociale, që është e rregulluar nga një Ligj që nuk është plotësuar, që nga viti 2002, dhe e kemi të trashëguar atë sistem të asistencës sociale dhe bashkërisht me Bankën Botërore do të dalim para përfundimit të vitit me rekomandime se si do t'i qasemi këtij Ligji. Është kriter që fëmija sapo ti mbush 5 vite t'ia ndalim ndihmën dhe ne duhet ti zbatojmë ato kritere, por që në agjendën tonë për vitin e ardhshëm do të jetë plotësim ndryshimi i reformës së skemave sociale.

Njohja e stazhit të punës me Ligjin aktual të sistemit pensional të skemave të pensioneve të financuara nga shteti, ka paqartësi të njohja e stazhit. Ne kemi paraparë që në këtë koncept dokument dhe në Ligjin Bazik që do të del në sistemin pensional, t'iu njihet stazhi të gjithë atyre që janë dëbuar dhunshëm nga punë në vitet '90-'99.

Është në përfundim procedura për dërgim në Qeveri të Projektligji për Lehonat dhe realisht është një ligj që avancon gruan në tregun e punës dhe kemi nxjerrë dispozita të qarta, ku krijohet një siguri që gruaja të ketë rol në tregun e punës.

Për lehonat e kemi paraparë, që 3 muajt e parë të paguhet nga punëdhënësi 70%, e pagës, për gjashtë muaj të paguhet 50% nga Shteti dhe tre muaj pushim pa pagesë.

Sa i përket kontratave kolektive, duhet të jenë diçka përtej ligjit dhe se si e tillë do të jetë e miratuar në muajin nëntor. Ne realisht nuk kemi sigurime sociale. Unë mendoj që me reformën dhe Projektligjin për Sigurimin Social dhe krijimin e fondeve për sigurime sociale, do të jetë bazamenti i parë i fillimit të instalimit të sigurimit social në vend.

Sa i përket viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës, për një periudhë të shkurtër kohore prej marrjes së mandatit në shtator deri në shkurt të këtij viti, Komisioni shtetëror është bërë funksional me krejt aktet nënligjorë, me krejt buxhetin dhe e kemi funksionalizuar një komision që me vite nuk ka funksionuar.

Në MPMS, nuk flitet vetëm për pensione, por flitet shumë për punë dhe është një sfidë në vete, çështja e papunësisë në bazë të statistikave, 30% janë të papunë dhe ne përpiqemi vazhdimisht që shkalla e papunësisë të jetë më e ulët, por nuk mund të rregullohet kjo çështje për një mandat. Janë 95 mijë punëkërkues të regjistruar në qendrën e punësimit dhe në anën tjetër kemi biznese që ankohen që nuk kanë punëtorë profesionalë çfarë atyre ju nevojiten dhe këtu shihet që nuk ka funksionuar diçka. Ne si ministri, po e bëjmë një plan nacional për orientimin e të rinjve për aftësimin profesional, për arsye që t'i orientojmë të rinjtë në karrierë në bazë të nevojave të tregut të punës.

Unë jam ballafaquar me një situatë, ku auditori i përgjithshëm në pasqyrat e auditimit të vitit 2016-17 radhazi për dy vite ka konstatuar një shkelje madje e ka cilësuar si shkelje të rëndë, në vitin 2015-16 dëmtim të buxhetit mbi 700 mijë euro dhe ai rekomandim, ajo e gjetur e auditorit të përgjithshëm është votuar radhazi në Parlamentin e Kosovës. Ne jemi duke e zbatuar një vendim të një institucioni që e ka votuar edhe Parlamenti dhe me keqardhje them se atje precizohet qartë e drejta e pensioneve të TMK-së, por me Ligjin për Kategorinë e të dala nga Lufta ka kufizime.

Janë tetë Ligje që e rregullojnë fushën e pensioneve, të cilat nuk janë të harmonizuara njëra me tjetrën sepse njëri Ligj i jep të drejtë, kurse tjetri ua ndalon.

Rasti i punëtores që e përmendi z.Haxhiu, pa dashtë me hy në detaje, unë e respektoj angazhimin e secilit punëtor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe çmoj çdo kontribut të tyre sepse në instancë të punës, ne nuk mund të flasim për asnjë sukses, nëse nuk e respektojmë punëtorin. Zonja në fjalë është në procedura gjyqësore.

Sa i përket Komisionit për të dhunuarat gjatë luftës, përbërja e Komisionit është miratuar në Qeveri dhe në qoftë se ka kundërshtim me ndonjë anëtarë të Komisionit, duhet të na informojnë.

**Flora Brovina**, tha se gjendja e qendrave sociale dhe pozita e tyre pas ndryshimit apo decentralizimit është mjaftë e rëndë. Kemi shumë ankesa se nuk iu mjafton buxheti, gjithashtu, ka probleme me kuadrot dhe me intereson ta dijë a keni bashkëpunuar me këto komuna?

**Skender Recica, ministër**, theksoi se funksionimi i qendrave sociale pas shkëputjes nga Ministria e Punës, është në situatë shumë të keqe, këto qendra janë bërë pjesë të komunave, por në përjashtim që janë shkëput nga menaxhimi i Ministrisë së Punës, nuk kanë përfituar ndihmë tjetër nga komunat sepse nuk ka pasur buxhet të mjaftueshëm.

Ditë më parë, më mbledhjen e fundit të Qeverisë, është miratuar edhe koncept dokumenti i Ligjit për Financat e pushtetit lokal, ku është paraparë buxhet i veçantë për qendrat sociale.

**Bekim Haxhiu**, theksoi se sa i përket skemës sociale, ka ankesa për shkak se nëse një person gjenë punë në kohëzgjatje tre muaj i ndalet asistencë sociale, dhe në momentin që largohet nga puna, për tu kthyer në skemën pensionale i duhen një mori dokumentesh dhe për këtë arsye shumica preferojnë të punojnë në mënyrë ilegale, që më pas mos të ballafaqohen përsëri me këto vështirësi.

Sa i përket ligjeve, asnjë ligj në Parlamentin e Kosovës nuk ka ardhur pa kaluar nga Zyra Ligjore e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale, por kontinuiteti i draftimit të ligjeve po vazhdon edhe sot, duke mos i përfshirë deputetët në fazat fillestare.

Është e drejtë e Ministrisë ta bëjë koncept dokumentin edhe draftimin në faza fillestare, por maksimumi çka mund të ndërhyhet në amendamente në Kuvendin e Kosovës është deri në 40%, nëse ligji i ka 100 nene, ne mund t'ia bëjmë dyzetë amendamente. Kjo është e drejta jonë si deputetë dhe ne nuk mund ta ndryshojmë ligjin dhe nuk mund t'i fajësojmë deputetët që ministritë paraprakisht kanë përgatitur ligje të dobëta.

**Skender Recica**, ministër, theksoi se në esencë po të shikohet, asistencë sociale i ndahet familjes. Kemi dy kategori që i mbështesim në asistencë sociale; kategoria e parë ku ato familje që nuk e kanë të aftë asnjë familjarë për të punuar dhe kemi kategorinë e dytë që të paktën një anëtarë është i aftë për punë, dhe nëse një ditë të vetme punësohet ai person, atij i ndalet asistencë sociale. Është një procedurë për tu kthyer prapë në asistencë sociale dhe nuk mund të dalim jashtë kriterëve dhe pas raportit që do të dalim brenda këtij viti, bashkërisht me Bankën Botërore do të jetë një çështje që do ta trajtojmë me një rregullim për vitin e ardhshëm.

Të hartimi i ligjeve unë pajtohem që ndoshta duhet të involvohet edhe Parlamenti në fazën e hershme të draftimit të Ligjeve, por realisht ekspertët ligjorë kanë procedura dhe është një rregullore dhe ne duhet ti zbatojmë ato.

**Fatmire Kollçaku**, tha se më herët e përmenda pushimin me pagesë për të sëmurët me sëmundje të rënda. Nuk ka nevojë me pas një fond ekzistues, personat që marrin kimioterapi pasi që mjafton të mos t'iu ndërpritet paga.

**Kryetarja**, tha se është evidente çështja që e ceku z.Fatmire që në vendet e punës personat që marrin kimioterapi janë në fazën terminale, ata janë të obliguar të shkojnë në vendin e pune edhe pse kontributi i tyre është i pamundur, duke pasur parasysh gjendjen e tyre shëndetësore.

**Skender Recica**, the se jemi në rrugë të mirë për të adresuar me kontratat kolektive. Po besoj që Komisioni do të na sjellë raportin brenda kësaj jave, dhe në javën e ardhshme, ne mendojmë që ta qesim në KES për miratim të harmonizuar, që realisht do të trajtohet edhe kjo çështje.

### **3. Të ndryshme.**

**Kryetarja**, njoftoi se më 4.11.2018, do të mbahet dëgjimi publik për Inspektoratin e Punës, ndërkaq më 5.11.2018, në mbledhjen e Komisionit, do të jetë i ftuar ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili.

Mbledhja përfundoi në orën 12:10.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i Komisionit.**

**Kryetarja e Komisionit,**

---

**Besa BAFTIU**